

Shkolla në Baden-Württemberg

- Çdo i ri në Gjermani shkon në shkollë. **Në shkollë të rinjtë mësojnë** të marrin përsipër përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e tyre në shtet dhe shoqëri. Shkolla i përgatit të rinjtë të bëjnë një jetë të pavarur.
- Shkolla nis me **shkollën fillore**. Normalisht ajo zgjat 4 vjet. Nga klasa e 5-të fëmija shkon në një **shkollë më lart** në Baden-Württemberg.
- **Strukturat dhe rregullat** janë njësoj ose të ngjashme në çdo shkollë fillore dhe shkollat më të larta. Është e rëndësishme që ato të dihen.
- Në shkollë **fëmijët me kombësi të ndryshme**, qofshin **vajza apo djem**, mësojnë **bashkë** në klasë. Fëmijët mësojnë si të kenë **respekt për njëri-tjetrin** dhe të sillen mirë në shoqëri.
- **Fëmijët që kanë të drejtë për mbështetje të veçantë pedagogjike** mund të shkojnë në shkolla speciale (SBBZ). Ata mund të ndjekin edhe shkolla të përgjithshme. Kjo quhet përfshirje.
- Me **SBBZ** merren parasysh qendrat e formimit të veçantë pedagogjike dhe këshillimit. Ato ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse të formimit të veçantë pedagogjik për nxënësit. Kjo bazohet në nevojat individuale të nxënësve. Me ndihmën e diagnostifikimit të veçantë pedagogjik, përcaktohen nevojat për mbështetje të një nxënësi.
- Ka **SBBZ me përparësi të veçanta mbështetjeje**. Për shembull: Të mësuarit, zhvillimi emocional dhe social, të shikuarit, të dëgjuarit, zhvillimi trupor dhe motorik, ...
- **Përfshirje** do të thotë që fëmijët me dhe pa të drejta për mbështetje të veçantë pedagogjike të mund të mësojnë bashkë në klasë ose shkollë.
- **Nga moshë 6 vjeç duhet që të gjithë fëmijët të shkojnë në shkollë fillore**. Ekziston një **detyrim ligjor për shkollim**. Në Baden-Württemberg është ligj që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të shkojnë në shkollë. Kjo vlen edhe për fëmijët dhe të rinjtë që lejohen të qëndrojnë në Baden-Württemberg në bazë të një kërkesë për azil ose që kanë autorizim. Këtë gjë e rregullon paragrafi 72 i ligjit arsimor për Baden-Württemberg.
- Para fillimit të shkollës nxënësit marrin librat dhe duhet që në fund të vitit t'i kthejnë thuajse të gjithë. **Për ndjekjen e një shkolle shtetërore prindërit nuk duhet të paguajnë**. Megjithatë, prindërit duhet që shpesh të paguajnë për materiale të caktuara si fletore, stilolapsa, çanta shkolle, ... Prindërit kanë gjithashtu detyrimin që të sigurojnë **transportin për në shkollë dhe ta paguajnë**. Por ka edhe përjashtime. Më pas mundet që prindërit të pyesin në sekretariatit e shkollës.

- Fëmijët ndahen në klasa. Çdo klasë ka një **mësuese** ose **mësues**. Kjo **mësuese apo mësues** është **personi i kontaktit për fëmijët e një klase dhe për prindërit e tyre**.
- **Viti shkollor** fillon në shtator dhe përfundon në korrik të vitit pasardhës. Fëmijët në shkollë fillore ose shkolla më të larta kanë përgjithësisht 6 javë **pushime nga shkolla**. Në këto kohë nuk ka mësim.
- Të gjithë nxënësit marrin një **orar** me lëndët mësimore. Kohët ndryshojnë nga niveli i klasës te tjetri, por lëndët jo gjithmonë.
- Njohuritë dhe aftësitë në një lëndë të caktuar shpërndahen në mënyra të ndryshme në **mësim**. Mësuesit zhvillojnë mësimin.
- Normalisht një **orë mësimi** zgjat 45 minuta. Në orarin mësimor vlejnë edhe orët e dyfishta (2 x 45 minuta).
- Mes orëve mësimore mund të bëhet një **pushim** prej 5 minutash. Ka edhe pushime më të gjata. Në të paktën një pushim çdo paradite është koha për ngrënie, pije, lëvizje dhe lodra. Zakonisht pushimi zhvillohet në oborrin e pushimit.
- Shpesh nxënësit duhet të mbarojnë **detyrat e shtëpisë** në shkollë ose pas mësimit. Me detyrat e shtëpisë fëmijët ushtrojnë dhe përsëritin mësimet në mënyrë të pavarur.
- Në shumë raste është e mundur që ata të ndjekin **mësime shtesë të gjuhës amtare** në shkollën e tyre ose në një shkollë pranë. Mësimi në gjuhën amtare ndihmon para se të gjithash aftësitë dhe njohuritë në gjuhën e origjinës. Ndjekja e mësimeve shtesë në gjuhën amtare mund të futet edhe në certifikatë. Për mësimin nuk është përgjegjëse shkolla, por konsullata përkatëse.
- Në shkollë nxënësit tregojnë se çfarë dinë dhe çfarë mund të mësojnë. Ata sillen mirë. **Njohuritë dhe aftësitë** përcaktojnë performancën. Kështu vlerësohet performanca. Edhe **sjellja** vlerësohet.
- **Performanca mund të kontrollohet me shkrim ose me gojë**. Për shembull përmes: Testimeve, punës në klasë, provimeve, detyrave të shtëpisë, prezantimeve, zgjidhjeve të detyrave në klasë, punës së përbashkët në orën e mësimit, ...
- Do të vlerësohet performanca, sjellja dhe bashkëpunimi: në **formë teksti** dhe në **formë notash me fjalë dhe notash me numra**. Nxënësit në klasën 11, 12 dhe 13 marrin **pikë**.
- **Notat** do të jepen me fjalë dhe numra: shumë mirë (Nota 1), mirë (Nota 2), kënaqshëm (Nota 3), mjaftueshëm

(Nota 4), mangët (Nota 5), pamjaftueshëm (Nota 6). **Notat për sjelljen dhe bashkëpunimin** do të jepen në fjalë: shumë mirë, mirë, kënaqshëm, jo kënaqshëm. Nxënësit në klasën 11, 12 dhe 13 marrin **pikë** nga 0 deri në 15. 15 është rezultati më i mirë. Në disa shkolla (shkollat komunitare) performanca përshkruhet në formën e një teksti.

- Nxënësit marrin dy vlerësime me shkrim të performancës së tyre të përgjithshme për çdo vit shkollor: një **informacion për gjysmën e vitit ose një certifikatë për gjysmën e vitit në fillim të shkurtit** dhe një **certifikatë vjetore ose përfundimtare në korrik**. Në shkollat komunitare fëmijët marrin një **raport mbi zhvillimin e të mësuarit**. Certifikatat janë dokumente me shkrim dhe do të nënshkruhen për t'ia kthyer sërish shkollës. Infomacioni i gjysmë vitit mundet në klasën e dytë dhe të tretë mund të jepet edhe në mbledhjen e prindërve ku merr pjesë edhe fëmija.
- Në shumë shkolla vlerësimet në certifikatën vjetore ose përfundimtare përbëjnë bazën për ndjekjen e një viti më lart. Kur një fëmijë ka probleme të mëdha me të mësuarit, mundet ose duhet **të përsërisë klasën** ose ka të drejtën të marrë mbështetje të veçantë pedagogjike **në një SBBZ**.
- Nga nxënësit pritet që ata t'u përmbahen **rregullave të shkollës**: p.sh. të jenë të përpiktë, të marrin pjesë aktivisht në mësim, të kenë me vete materialet e nevojshme shkollore, t'i përmbahen rregullores së shkollës, të shkojnë në takime ose t'i anulojnë brenda një kohe të arsyeshme, ...
- **Ka pasoja kur nxënësit nuk i zbatojnë rregullat**. Mësuesi apo mësuesja mund të japë p.sh. detyra shtesë ose t'i vënë në një vend tjetër, ... mund të ndodhin akte më të rënda: Hyrje në regjistrin e klasës, ndalim apo edhe përjashtim nga klasa. Ndëshkimet fizike si shpullat **nuk** lejohen.
- **Kur fëmija është sëmurë** dhe nuk mund të vijë në shkollë në raste përjashtimore, **duhet të justifikohet**. Kjo mund të bëhet duke dhënë informacion përmes telefonit, postës, emailit. Se si duhet bërë justifikimi, kjo varet nga shkolla.
- **Prindërit mund të bëjnë shumë për të siguruar që fëmijët e tyre** të ndjekin shkollën me sukses. Fëmijët zhvillohen mirë kur i mbështetin prindërit. Për shembull, prindërit mund t'i inkurajojnë fëmijët e tyre që t'u përkushtohen kërkesave.